

VENDIM
Nr. 792, datë 12.12.2022

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 151, DATË 10.3.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË ÇERDHE ‘VALIAS’,
NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË FSHATIN VALIAS,
BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 151, datë 10.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 65 646 444 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të çerdhes në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.”.

b) Në pikën 3, fjalët “... sipas pikave 1 dhe 2 ...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, dhe 2/1 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku